

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Elementet e njohurive të  
Auditimit të Brendshëm  
Internal Audit Knowledge  
Elements**

**B1**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data 09.06.2018

CONTENT / PËRMBAITJA

<b>Pjesa</b>	<b>Maksimumi i Dhënë</b>	<u>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK- PIKËT E DHËNA</u>
1. Pyetje (50 x 2 pikë)	100	
<b>Total</b>	100	

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**  
**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

1. Cila nga të mëposhtmet nuk përfaqëson rolin e duhur të bordit të drejtorëve të korporatave?
  - A. Kujdestar.
  - B. Qeverisës.
  - C. Garantues.
  - D. Udheheqës.
2. Linja e poshtme e trefishtë, e cila përqendrohet në një këndvështrim më të gjerë të palëve të interesuara për qeverisjen e korporatave, nuk adreson cilën nga të mëposhtmet?
  - A. Objektivat financiare.
  - B. Objektivat shoqërore.
  - C. Objektivat mjedisore.
  - D. Objektivat teknike.
3. Të gjitha nga çështjet në vijim ishin arsye të forta për krizen financiare të kohëve të fundit, investime të rrezikshme dhe skema mashtruese / mashtrime që ndodhën në industrinë financiare të ShBA-së përveç të:
  - A. Gabimeve në qeverisje.
  - B. Gabimeve operacionale.
  - C. Shkeljeve ligjore.
  - D. Shkeljeve etike.
4. Në lidhje me etikën ndërkombëtare të biznesit, cila nga të mëposhtmet është cituar si një argument në favor të mitos (ryshfetit)?
  - A. Individit nuk duhet të komprometojë besimet e individit tjetër.
  - B. Individët që marrin mito (ryshfete) janë të vetmit që përfitojnë.
  - C. Kjo është një praktikë normale dhe e pritshme në shumë vende.
  - D. Individit duhet të marr qëndrim për ndershmërinë, moralin dhe etikën.
5. Cili lloj i përgjegjësisë sociale përfshin ato aktivitete dhe praktika që priten apo ndalohen nga anëtarët e shoqërisë edhe pse ato nuk janë të kodifikuara në ligj?
  - A. Përgjegjësitë etike.
  - B. Përgjegjësitë ligjore.
  - C. Përgjegjësitë filantropike. Përgjegjësitë filantropike përfshijnë dhurimin e parave dhe pronës në programet sociale.
  - D. Përgjegjësitë ekonomike.
6. Rreziku përcaktohet si:
  - A. Pasiguri për sa i përket humbjes.
  - B. Devijimi i mundshëm i aktuales nga përvoja e pritshme.
  - C. Shanset afatgjata të ndodhjes ose frekuenca relative e humbjes.
  - D. Një pasiguri specifike që mund të shkaktojë humbje.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**  
**Grumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!** **Nga 2 pikë secila**

7. Cila nga deklaratat e mëposhtme është e saktë në lidhje me menaxhimin e rrezikut?
- A. Buxhetimi i kapitalit dhe analiza statistikore nuk mund të përdoren për të zgjedhur kombinimin më të mirë të mbajtjes dhe transferimit të rrezikut.
  - B. Shuma e rimbursushme dhe vetë-sigurimi nuk mund të përdoren së bashku.
  - C. Buxhetimi i kapitalit dhe analiza statistikore mund të përdoren për të zgjedhur kombinimin më të mirë të mbajtjes dhe transferimit të rrezikut.
  - D. Transferimi i rrezikut është e njëjta gjë si sigurimi.
8. Sa i përket mjeteve të menaxhimit të rrezikut, teknika Delphi është një metodë e përdorur për të shmangur cilën nga të mëposhtmet?
- A. Ndryshimin e grupit.
  - B. Dinamiken e grupit.
  - C. Të menduarit si grup.
  - D. Kulturën e grupit.
9. Cila nga të mëposhtmet nuk paraqet qëllimin e iniciativave të menaxhimit të rrezikut të ndërmarrjes (ERM)?
- A. Integrimi i rreziqeve.
  - B. Krijimi i vlerës së aksionarëve.
  - C. Mbrojtja e vlerës së aksionarëve.
  - D. Rritja e vlerës së aksionarëve.
10. Cila nga të mëposhtmet është pengesa kryesore gjatë implementimit të programit të menaxhimit të rrezikut të ndërmarrjes?
- A. Përfitimet e paqarta.
  - B. Mungesa e mjeteve.
  - C. Betejat organizative në terren.
  - D. Kultura organizative.
11. Mbajtja e rrezikut është më e përshtatshme për situatat në të cilat ekziston një:
- A. Frekuencë e ulët dhe ashpërsi e lartë.
  - B. Frekuencë e lartë dhe ashpërsi e lartë.
  - C. Frekuencë e ulët dhe ashpërsi e ulët.
  - D. Frekuencë e lartë dhe ashpërsi e ulët.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**  
**Grumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!** **Nga 2 pikë secila**

12. Në lidhje me menaxhimin e rrezikut të ndërmarrjes (ERM), cila nga të mëposhtmet është më e vështira për t'u identifikuar dhe vlerësuar?

- I. Rreziku i rastësisë.
- II. Rreziku financiar.
- III. Rreziku strategjik.
- IV. Rreziku operacional.

- A. Vetëm I.
- B. Vetëm II.
- C. I dhe II.
- D. III dhe IV.**

13. Disa studiues të menaxhmentit i kanë dhënë kredi Douglas McGregor-it me rastin e themelimit të fushës së sjelljes organizative dhe duke nxjerr kështu një grup modern të supozimeve rreth njerëzve. Identifikoni supozimin bazik që bazohet në teorinë Y të McGregor-it.

- A. Të punësuarit janë dembelë dhe pa ambicie.
- B. Të punësuarit shqetësohen vetëm për paga më të larta.
- C. Punonjësit janë pjesë përbërëse e sistemit organizativ.
- D. Punonjësit janë individë energjikë dhe krijues.**

14. Në një projekt që kishte për qëllim të kryej një mision specifik në hapësirën kozmike u krijua një ekip që kombinonte punonjësit nga disa departamente, të cilët u bashkuan dhe u bënë si një organizatë e përkohshme brenda një laboratorit të madh. Ky është një shembull i:

- A. Qasjes socio-teknologjike.
- B. Organizatës matricë.**
- C. Menaxhimit nga objektiva.
- D. Organizatës së decentralizuar.

15. Cili nga faktorët e mëposhtëm ka më pak të ngjarë të ndikojë në fushëveprimin e drejtpërdrejtë të menaxherit?

- A. Shpeshtësia e kontaktit mbikëqyrës-vartës.
- B. Vullneti i menaxherit për të deleguar autoritetin.
- C. Aftësitë e trajnimit dhe të komunikimit të menaxherit.
- D. Numri i njerëzve në korporatë.**

16. Të gjitha nga të mëposhtmet janë karakteristika të organizatave vertikale, përveç:

- A. Detyrave të specializuara.
- B. Vendimmarrjes së decentralizuar.**
- C. Pak ekupe, task-forcat ose menaxherët e projektit.
- D. Kultura e ashpër.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.  
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

17. E meta themelore e çmimeve kosto-plus është se ajo:
- A. Nuk merr parasysh konkurrencën.
  - B. Injoron kërkesën.
  - C. Injoron politikat standarde të marzhave në industri.
  - D. Vendos shumë theks mbi konkurrencën.
18. Cila nga të mëposhtmet nuk është një formë e çmimit që është elastike ndaj konsumatorëve?
- A. Bonuset e zbritjes.
  - B. Kuponët.
  - C. Çmimet e segmentuara.
  - D. Promovimi i çmimeve.
19. Masat e cilësisë, si pjesë e performancës së furnizuesit, nuk përfshijnë cilën nga të mëposhtmet?
- A. Normat e dëmtimeve në hyrje.
  - B. Ndryshueshmërinë e produktit.
  - C. Numrin e ankesave të konsumatorëve.
  - D. Saktësinë e sasisë.
20. Cila nga të mëposhtmet do të lejojë një prodhues me burime të kufizuara të maksimizojë fitimet?
- A. Teknika Delphi.
  - B. Zbutja eksponenciale.
  - C. Analiza e regresionit.
  - D. Programimi linear.
21. Kostot e mbajtjes se inventarit përfshijnë cilën nga këto?
- A. Kostot e magazinimit.
  - B. Kostot e marketingut.
  - C. Kostot e paketimit.
  - D. Kostot e promovimit të shitjeve.
22. Shumica e aplikacioneve të tregtisë elektronike përdorin cilën nga këto?
- A. Arkitekturën një-shtresore.
  - B. Arkitekturën dy-shtresore.
  - C. Arkitekturën tri-shtresore.
  - D. Arkitekturën katër-shtresore.
23. Cila nga të mëposhtmet vepron si një kanal komunikimi që rrjedh brenda zinxhirit të komandës ose detyrës me përgjegjësi të përcaktuar nga organizata?
- A. Komunikimi formal.
  - B. Komunikimi horizontal.
  - C. Komunikimi nga lart-poshtë.
  - D. Komunikimi nga poshtë-lart.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**  
**Mrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!** **Nga 2 pikë secila**

24. Kush janë pronarët bazë të një korporate?

- A. Aksionarët.
- B. Bordi i drejtorëve.
- C. Menaxhmenti.
- D. Punonjësit.

25. Cila nga këto është një disavantazh i strukturës shumëdimensionale?

- A. Konkurrenca për burimet e korporatës mund të krijojë vështirësi në koordinim.
- B. Menaxhmenti i nivelit korporativ është i shkarkuar nga çështjet ditore.
- C. Çdo biznes i përqendron përpjekjet e veta në nevojat e palëve të saja të veçanta të interesit.
- D. Asnjë dublikim në funksionet organizative mbështetëse, siç janë kontabiliteti.

26. Strategjia e kostos-më të mirë është e ngjashme me cilën nga strategjitë e përgjithshme të biznesit të listuara më poshtë?

- A. Diferencimi i kombinuar me udhëheqjen e kostos.
- B. Fokusi i diferencimit.
- C. Udhëheqja e kostos.
- D. Fokusi i kostos.

27. Në metodologjinë gjashtë sigma, faza e "analizës" shërben si rezultat (produkt) i cilës prej fazave të mëposhtme?

- A. Definimit.
- B. Kontrollit.
- C. Matjes.
- D. Përmirësimit.

28. Kostot e cilësisë mund të kategorizohen si më poshtë:

- I. Kostot e parandalimit. Kjo përfshin eliminimin e prodhimit të produkteve që nuk janë në përputhje me kërkesat e cilësisë. Kostot përfshijnë dizajnimin dhe testimin e produktit dhe procesit, vlerësimin dhe trajnimin e furnizuesit, trajnimin e punonjësve dhe mirëmbajtjen parandaluese.
- II. Kostot e vlerësimit. Kjo përfshin zbulimin e produkteve që nuk janë në përputhje me kërkesat e cilësisë. Kostot përfshijnë inspektimin, testimin dhe kontrollin e cilësisë statistikore.
- III. Kostot e dështimit të brendshëm. Kjo përfshin korrigjimin ose heqjen e produkteve që nuk janë në përputhje me kërkesat e cilësisë përpara se ato të transportohen. Kostot përfshijnë ripunimin, mbeturinat, ritestimin dhe ndryshimet në dizajnimin e produktit ose procesit.
- IV. Kostot e dështimit të jashtëm. Kjo përfshin zbulimin e produkteve që nuk janë në përputhje me kërkesat e cilësisë nga konsumatorët pas dërgesës. Kostot përfshijnë lejimet, ankesat e klientit, shërbimin, garancinë, detyrimin e produktit, vullnetin e mirë të humbur nga konsumatorët dhe produktet e rikthyera.

Menaxhmenti i një kompanie është duke u përpjekur të ndërtojë reputacionin si një prodhues i klasit botëror të produkteve cilësore. Cila nga katër kostot do të ishte më e dëmshme për të ndërtuar reputacionin si një prodhues i klasit botëror?

- A. Kostot e parandalimit.
- B. Kostot e vlerësimit.
- C. Kostot e dështimit të brendshëm.
- D. Kostot e dështimit të jashtëm.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**  
**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

29. Shumë firma kanë modele të vendndodhjes për të parashikuar shitjet e ardhshme (Y) në vendet që ende duhet të zhvillohen. Disa variabla sqaruese që mund të përdoren janë: dendësia e popullsisë brenda një sipërfaqe specifike (X1), qarkullimi i trafikut (X2), numri i konkurrentëve (X3) dhe lehtësia e hyrjes në dhe jashtë vendndodhjes së propozuar (X4). Një dokument i shkurtuar kompjuterik në kopje fizike i një analize lineare jep këto të dhëna:

Variabla e varur: Y N: 12

R: 0.986 R në katror: 0.972

Gabimi standard: 3800

Variabla	Koeficienti
Konstante	124,000
X1	5
X2	350
X3	-1,700
X4	4,000

Në qoftë se, për një vendndodhje që është duke u shqyrtuar kemi  $X1=10,000$ ,  $X2=300$ ,  $X3=9$  dhe  $X4=1$ , shitjet e parashikuara do të ishin të barabarta me:

- A. 124,000.
- B. 126,655.
- C. 143,700.
- D. 267,700.

30. Zgjerimi i punës do të thotë:

- A. Ngarkimi vertikal i punës.
- B. Ngarkimi horizontal i punës.
- C. Ngarkimi paralel i punës.
- D. Ngarkimi linear i punës.

31. Sipas teorisë rrugë-qëllim të lidshipit, përpjekjet e punonjësve nuk rriten kur:

- A. Lideri sqaron se si punonjësit mund të marrin shpërblime.
- B. Lideri ndryshon shpërblimet në dispozicion për të punësuarit.
- C. Sjellja e liderit i përshtatet situatës aktuale.
- D. Lideri ndëshkon punonjësit.

32. Cilat nga deklaratat e mëposhtme janë të vërteta në lidhje me kontrollet e qasjes dhe sigurinë?

- I. Politikat më komplekse të sigurisë kanë nevojë për kontrolle më fleksibile të qasjes.
- II. Shtimi i fleksibilitetit në modelet e kufizuara të kontrollit të qasjes rrit problemet e sigurisë.
- III. Një kompromis ekziston midis fuqisë ekspresive të një modeli të kontrollit të qasjes dhe lehtësisë së zbatimit të sigurisë.
- IV. Në modelin e kufizuar të qasjes implicite, zbatimi i sigurisë është relativisht më i lehtë sesa në modelin e kufizimeve arbitrare.

- A. I dhe III.
- B. II dhe III.
- C. III dhe IV.
- D. I, II, III dhe IV.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë. Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

33. Kontrolli i qasjes logjike siguron një mjet teknik për kontrollin e qasjes në sistemet kompjuterike. Cila nga këto nuk është një përfitim i kontrolleve të qasjes logjike?



- A. Integriteti.
- B. Disponueshmëria.
- C. Besueshmëria.
- D. Konfidencialiteti.

34. Cila nga metodologjitë ose teknikat e mëposhtme siguron strategjinë më efektive për kufizimin e qasjes në dosjet individuale të ndjeshme?

- A. Listat e kontrollit të qasjes dhe kontrolli diskrecional i qasjes si dhe kontrolli i detyrueshëm i qasjes.
- B. Kontrolli i detyrueshëm i qasjes dhe lista e kontrollit të qasjes.
- C. Kontrolli diskrecional i qasjes dhe lista e kontrollit të qasjes.
- D. Kontrolli fizik i qasjes në harduer dhe në listën e kontrollit të qasjes me kontroll diskrecional të qasjes.

35. Cila nga këto nuk është një input për strategjinë e menaxhimit të rrezikut dhe të sigurisë së informacionit?

- A. Strategjia e biznesit.
- B. Kërkesat e sigurisë.
- C. Proceset e biznesit.
- D. Vlerësimet e rrezikut.

36. Cili nga të mëposhtmet është më e sigurtë?

- A. Sistemi i çelësit privat.
- B. Sistemi i çelësit publik.
- C. Sistemi i çelësit të autenticitetit.
- D. Sistemi i kodimit të çelësave.

37. Nënshkrimet digjitale nuk përdoren për cilën nga të mëposhtmet?

- A. Autenticitetin.
- B. Disponueshmërinë.
- C. Mos mohimin.
- D. Integritetin.

38. Cila nga këto është një shembull i linjës së fundit të mbrojtjes në siguri?

- A. Vigjilenca e punonjësve.
- B. Kontrollat e ndryshimeve të programit.
- C. Teknikat e tolerancës së gabimit.
- D. Mbrojtja e jashtme.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.  
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!** Nga 2 pikë secila

39. Një kontroll efektiv i sigurisë fizike gjatë qasjes në pajisje dhe sisteme të ndjeshme, përfshin cilën nga këto?

- A. Kartelat e mençura (smart).

B. Masat biometrike.

C. Foto ID.

D. Kombinimin e kartelës së mençur 'smart', masës biometrike dhe foto ID.

40. Një klasë e gabimit gjatë përpunimit të të dhënave është dështimi për të futur të gjitha të dhënat që duhet të paraqiten në sistem. Cilën nga të mëposhtmet do të prisni që menaxhmenti do ta instalojë në përpjekjet e tyre për të zbuluar këtë klasë gabimi?

A. Kontrollin e ekzistencës.

B. Kontrollin e totaleve.

C. Kontrollin e kufirit.

D. Kontrollin e arsyeshmërisë.

41. Cilat nga detyrat e mëposhtme duhet të kryhen para vendosjes së një sistemi të informacionit në operacionin e prodhimit?

I. Analizimi i kërkesave funksionale.

II. Analizimi i kërkesave të sigurisë.

III. Kryerja e rishikimeve të dizajnit të sistemit.

IV. Kryerja e testeve të sistemit

A. I dhe II.

B. II dhe III.

C. II dhe IV.

D. III dhe IV.

42. Kompania prodhuese ABC transporton mallra që kushtojnë 40,000€ nën konsignacion në dyqanet e kompanisë XYZ. ABC paguan 3,000€ të shpenzimeve të transportit tek kompania transportuese dhe XYZ paguan 2,000€ për shpenzimet e reklamimit lokal që janë të rimbursueshme nga ABC. Deri në fund të periudhës, tre të katërtat e mallrave nën konsignacion janë shitur për 50,000€. XYZ e njofton ABC për shitjet, mban një komision prej 10% dhe shpenzimet e paguara të reklamave si dhe zvogëlon paratë e gatshme të ABC për shumën përkatëse. Zgjidhni regjistrimet e duhura në ditar që në mënyrë adekuate përshkruan shitjen dhe arkëtimin e parave të gatshme nga ABC.

I.	Paraja e gatshme	Shp. e reklamave	Shp. e komisionit	Shp. e transportit	Të hyrat nga shitja e mallrave
	40,000	2,000	5,000	3,000	50,000

II.	Paraja e gatshme	Shp. e reklamave	Shp. e komisionit	Të hyrat nga shitja e mallrave
	43,000	2,000	5,000	50,000

III.	Paraja e gatshme	Të hyrat nga shitja e mallrave
	50,000	50,000

IV.	Paraja e gatshme	Shp. e komisionit	Të hyrat nga shitja e mallrave
	45,000	5,000	50,000

A. I.

B. II.

C. III.

D. IV.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.**

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

43 Cila pasqyrë financiare duhet të përdoret kryesisht nga një investitor për të vlerësuar shumat, kohën dhe pasigurinë e aktiviteteve investuese dhe financuese të kompanisë ABC?

A. Pasqyra e operacioneve.

B. Pasqyra ndryshimeve në ekuitet.

- C. Pasqyra e pozitës financiare.
- D. Pasqyra e rrjedhës së parasë.

44. Vlera aktuale e përfitimeve të ardhshme të pagueshme si rezultat i punës së kryer para fillimit ose ndryshimit në një plan pensioni, është përcaktimi i:

- A. Detyrimeve minimale.
- B. Vlerës së drejtë të pasurive të skemës.
- C. Obligimeve të përfitimit të parashikuar.
- D. Kostos së shërbimit paraprak.

45. Cila nga të mëposhtmet nuk është një bazë e përshtatshme për matjen e kostos historike të pasurive fikse?

- A. Çmimi i blerjes, kostot e transportit dhe kostot e instalimit të një pasurie produktive duhet të përfshihen në koston e pasurisë.
- B. Të ardhurat e fituara në procesin e përgatitjes së tokës për qëllimin e synuar, siç është shitja e drurit të pastruar, duhet të njihen menjëherë në të ardhura.
- C. Shpenzimet e përmirësimit të pajisjeve të bëra pas blerjes së saj duhet të shtohen në koston e pasurisë nëse ato rrisin jetëgjatësinë e saj dhe sigurojnë potencial të ardhshëm të shërbimit.
- D. Të gjitha shpenzimet e bëra në ndërtimin e një ndërtese të fabrikës, nga gjermimi deri në përfundim, duhet të konsiderohen si pjesë e kostos së pasurisë.

46. Vendimi i strukturës së kapitalit përfshin proporcionin e financimit me:

- A. Borxh afatgjatë kundrejt borxhit afatshkurtër.
- B. Borxh kundrejt kapitalit.
- C. Pasuri qarkulluese kundrejt pasurive joqarkulluese.
- D. Fitime të mbajtura kundrejt emetimit të aksioneve të reja.

47. Kur të gjithë treguesit tjerë janë të barabartë, një kompani me normë të lartë të dividendës së paguar do të ketë një Koeficient të detyrimeve kundrejt pasurive (Lista A) dhe një Koeficient Qarkullues (Lista B):

	I	II	III	IV
Lista A	I lartë	I lartë	I ulët	I ulët
Lista B	I lartë	I ulët	I lartë	I ulët

- A. I.
- B. II.
- C. III.
- D. IV.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë. Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

48. Supozoni se kostoja e mallrave të shitura të një kompanie për vitin 2012 ishte 1.8 milion euro, shitjet e saj ishin 3.2 milionë euro dhe të ardhurat neto ishin 190.000 euro. Tabela më poshtë paraqet një pasqyrë të pozitës financiare për kompaninë për vitin 2012.

Pasqyra e Pozitës Financiare më 31.12.2012	
<b>Pasuritë</b>	

<b>Pasuritë jo qarkulluese</b>	
Impiantet dhe pajisjet (kosto)	1,400,000 €
Zhvlerësimi i akumuluar	<u>400,000 €</u>
Impiantet dhe pajisjet neto	<b>1,000,000 €</b>
<b>Pasuritë qarkulluese</b>	
Paraja e gatshme	20,000 €
Investimet afatshkurtra	30,000 €
Llogaritë e arkëtueshme	200,000 €
Stoqet	540,000 €
<b>Total Pasuritë qarkulluese</b>	<b>790,000€</b>
<b>TOTAL PASURITË</b>	<b>1,790,000 €</b>
<b>Ekuiteti dhe Detyrimet</b>	
<b>Ekuiteti</b>	
Aksionet e zakonshme	200,000€
Kapitali i shtuar	180,000 €
Fitimet e mbajtura	300,000 €
<b>Total Ekuiteti</b>	<b>680,000 €</b>
<b>Detyrimet afatgjata</b>	<b>840,000 €</b>
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>	
Llogaritë e pagueshme	70,000 €
Notat e pagueshme	150,000 €
Pagat e pagueshme	30,000 €
<b>Total detyrimet afatshkurtra</b>	<b>270,000 €</b>
<b>TOTAL EKUITETI DHE DETYRIMET</b>	<b>1,790,000 €</b>

Cila është marzha e fitimit të kompanisë ?

- A. 5.94%.
- B. 10.55%.
- C. 10.61%.
- D. 27.94%.

49. Një kornizë shoqërore e ndërthurur lirshëm në të cilën individët priten të kujdesen për veten e tyre quhet:

- A. Kulturë.
- B. Etnocentrizëm.
- C. Individualizëm.
- D. Maskulizëm.

50. Të gjitha të mëposhtmet janë tregues ekonomikë që mund të tregojnë se është arritur punësimi i plotë, përveç të:

- A. Numrit të ulët të punëkërkesve.
- B. Nuk ka pengesa të cilat dalin nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë.
- C. Numrit të lartë të orëve të punës në javë.
- D. Nivelit të lartë të shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese.